



Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe  
EC MA NDRYSHE

## THIRRJE PËR OFERTË

### Zhvillimi i Databazës Hapësinore të Prizrenit

Programi për të drejtat e njeriut, "HUMAN RIGHTIVISM", i cili mbështetet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (Sida), ka për qëllim që nëpërmjet shoqërisë civile të përmirësoj të drejtat e njeriut, që janë të natyrshme, origjinale dhe të bazuara në interes të grupit, përmes këtyre tri komponentëve: 1) Të drejtat e njeriut dhe aktivizimi arsimor; 2) Dokumentimi; monitorimi (watchdog) dhe qasja strategjike dhe 3) Të drejtat mjedisore.

EC Ma Ndryshe është njëra nga organizatat përfituese të këtij programi, në kuadër të të cilit shpall këtë thirrje përmes së cilës fton ekspertët/grupet e ekspertëve, kompanitë/konsorciumet dhe OJQ-të e interesuara të dorëzojnë ofertat e tyre për **Zhvillimin e "Databazës Hapësinore të Prizrenit"**.

Zhvillimi i projektit/platformes i "Databazës Hapësinore të Prizrenit" ka për qëllim të kontribuojë në krijimin e një baze të dhënash për karakteristikat e rëndësishme të hapësirës së një qyteti, e rrjedhimisht të krijojë platformë të dhënash e cila mund të zhvillohet dhe përditësohet vazhdimisht. Kjo platformë do të jetë pikë referimi për një gamë të gjerë të projekteve që do të kenë synim qytetin e Prizrenit.

Krijimi dhe realizimi i Databazës Hapësinore të Prizrenit duhet të përmbajë analizë të gjendjes hapësinore të qytetit të Prizrenit në zonën e caktuar (me mundësi zgjerimi në të ardhmen) që si qëllim ka mbledhjen e të dhënave hapësinore, identifikimin e mundësive dhe potencialeve të qytetit të Prizrenit, si dhe krijimin e një platforme me të dhëna të cilat do t'i shërbejnë projekteve të zbatueshme potenciale në të ardhmen.

Produkti përfundimtar duhet të përfshijë edhe krijimin e platformës online të hartëzimit e cila duhet të jetë e qasshme me të gjitha të dhënat në dispozicion.

Në ofertë duhet të përfshihen:

- 1. Databaza** duhet të përmbajë (por nuk kufizohet në) këto të dhëna: Gjelbërimin me të gjitha karakteristikat; Hapësirat publike me karakteristikat e tyre; Mobiliarin urban me karakteristikat e tyre; Vlerësimin e zhurmës brenda zonës së përcaktuar; Matje të qarkullimit të trafikut; Pikat e trashëgimisë kulturore me karakteristikat e tyre; Fotografi; Matje të tjera që konsiderohen të vlefshme.

Si dhe të merren parasys:

Krijimi dhe konfigurimi i databazës, përfshirë instalimin e sistemit; Vlerësimi i databazës ekzistuese; Migrimi i të dhënave.

**OJQ Emancipimi Civil Ma Ndryshe (EC Ma Ndryshe)**

Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren ~ Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr.5, Prishtinë  
www.ecmandryshe.org ~ info@ecmandryshe.org ~ 029-222-771 & 038-224-967

- 2. Mobilizimi i personave për rilevim në terren** për mbledhjen e të dhënave të kërkuara me karakteristikat e tyre, dhe t'u sigurohen materialet e nevojshme të punës.  
Mbledhja e të dhënave në terren; Mobilizimi i personave për rilevim në terren; Trajnimi i tyre për rilevim; Sigurimi i mjeteve të punës; Futja e të dhënave në system; Verifikimi dhe kalibrimi i të dhënave.
- 3. Platforma** finale duhet të krijohet si platformë online ku: Procesohen të dhënat nga terreni; Paraqiten të gjitha të dhënat mbi hartën e qytetit me mundësi të filtrimit përmes filterëve të ndryshëm që tregojnë karakteristikat e secilës pikë të cekur më lart në databazë; Dizajnimi i platformës ashtu që të gjithë përdoruesit të ketë lehtësi në qasje në të dhëna; Të testohet dhe përmirësohet platforma në bazë të testimit; Të funksionalizohet platforma tërësisht për përdorim.

#### **Kriteret për ofertim:**

- Oferta duhet të përmbajë dokumentet në vijim:
- Për ekspertet/grupet e ekspertëve dërgohen vetëm CV-të e personave përgjegjës;
- Çertifikata e regjistrimit të biznesit/ OJQ-së, Çertifikata e numrit fiskal; Çertifikata e TVSH-së (kompanitë që janë deklaruese të TVSH-së), CV-të e personave që do të angazhohen për realizimin e aktivitetit;
- Ekspertët/grupet e ekspertëve, kompanitë/konsorciumet, OJQ-të që kanë portfolio (projekte të realizuara të kësaj natyre) rekomandohet (nuk është obligative) ti bashkangjesin në ofertë;
- Oferta duhet të përfshijë një përshkrim të shkurtë të metodologjisë së punës në terren, hulumtimit/analizës dhe një strukturë të përmbajtjes së platformës/databazës;
- Çmimi duhet të përfshijë koston profesionale, punës në terren, materialeve dhe ato të transportit;
- Pala ofertuese duhet të caktojë një person për kontakt direkt dhe komunikim me EC Ma Ndryshe;

Ofertat duhet të dorëzohen fizikisht në zyret e EC Ma Ndryshe, Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren ose në mënyrë elektronike në [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org) deri më datë 06.08.2021, ora 15:00 me shënim: *Zhvillimi i " Databazës Hapësinore të Prizrenit "*. Ofertat që vijnë pas këtij afati dhe ato që nuk i përmbajnë dokumentet relevante, nuk do të konsiderohen.

Për pyetje shtesë rreth kësaj thirrjeje mund të na kontaktoni në: [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org) deri më datë 02.08.2021.

Pas vlerësimit fillestar të ofertave, EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën të kërkojë dokumente (dëshmi) shtesë nga ekspertet/ grupi i ekspertëve/ kompanitë / OJQ-të, nëse këtë e vlerëson të nevojshme. EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën për të negociuar ofertën financiare.

Vetëm kompanitë/konsorciumet/OJQ-të fitues do të informohen/kontaktohen.